



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim Përgjigje .

Bashkia Shkodër referuar dispozitave ligjore në fuqi, ligjit 139/2015”Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit 119/2014 “Për të drejten e informimit” i ndryshuar, është transparente dhe korrekte ndaj informimit me qytetaret për përmbushjen e detyrave të saja funksionale.

Kërkesa e paraqitur nga ana juaj për llogari te SHTEG ku drejtor ekzekutiv është zj.Lindita Çela nuk ka të shoqëruar aktin e përfaqesimit për të cilën ju kërkon informacion.

• **Në lidhje me pikën 1**, ku kërkon; *një kopje të kontratave që ka Bashkia Shkodër në zotërim për hapësirat detare, të rërës dhe të plazheve në Velipojë*; ju informojme se;

Në zbatim të VKM nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, kontratat lidhen nga autoriteti i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, njësia e vetqeverisjes vendore është përfituese e këtyre kontratave në lidhje me vjeljen e tarifës së shfrytëzimit për zënien të hapësirës publike. Sipas azhurnimit të bërë, AKB-ja ka miratuar rreth 55 subjekte.

• **Në lidhje me pikën 2**, ku kërkon; *Pse zgjodhët si institucion themelimin dhe regjistrimin e një shoqërie aksionare si “Bio Strajca sh.a.”?*, ju informojme se;

Bashkia Shkodër referuar projektit: “Rikualifikim i Merkatës Rus (Mbulesa e Tregut Shkodër)”, është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR) të vitit 2023.

Referuar kushteve të thirrjes për aplikime të përcaktuara në VKM nr.125, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023” institucionet përfituese të grandit kanë patur detyrim ligjor krijimin e shoqërive aksionare për menaxhimin e tregjeve.

Me qëllim përfitimit të grandit Bashkia Shkodër ka krijuar shoqërinë “BIO STRAJCA” me anë të VKB-së nr.15 datë 20.07.2023.

• **Në lidhje me pikën 3**, ku kërkon; *Si funksionon kjo shoqëri aksionare?*, ju informojme se;

Shoqëria Aksionare funksionon në zbatim të ligjit 139/2015 ”Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar; ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe

statutit, akt themelimit të miratuar përmes VKB nr.15 datë 20.07.2023.
<https://bashkiashkoder.gov.al/vendime-te-keshillit/vendim-i-keshillit-bashkiak-nr-15-dt-20-07-2023/>

• **Në lidhje me pikën 4**, ku kërkoni; *Pse zgjodhët pikërisht shoqërinë aksionare “Bio Strajca sh.a.” për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike?*, ju informojme se;

Përmes VKB nr. 15 “Për krijimin e shoqërisë aksionare „Bio Strajca” , sh.a, si person juridik në pronësi të bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit, të vitit 2023 Bashkia Shkodër dhe Këshilli Bashkiak kanë themeluar shoqërinë aksionare me objekt kryesor menaxhimin dhe administrimin e tregjeve publike të Bashkisë. Sh.a. e cila tashmë me përfundimin e punimeve në tregun e rusit, por edhe me ndërhyrje të vogla në qytet, po bën hapat e saj drejt një performance të mirë administrative dhe financiare.

Kjo strukturë e organizuar në formë Sh.a. krijon mundësinë e administrimit më efikas të disa aseteve apo punëve të Bashkisë Shkodër duke arritur që të ketë të ardhura të vazhdueshme dhe rikthim të këtyre të ardhurave në investimet të tjera në territor. Ndryshimet e fundit ligjore përkatësisht VKM nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i japin të drejtën Njësive të Vetëqeverisjes Vendore që të bejë Administrimin/Menaxhimin e stacioneve të plazheve për të cilat nuk është lidhur kontratë me operator privat. Jo vetëm menaxhimi i plazheve por edhe menaxhimi i resurseve apo aseteve të tjera, ofrimi i shërbimeve të ndryshme turistike e kulturore dhe ekonomizimi i tyre do të jetë një mundësi e mirë për bashkinë Shkodër, për të ofruar shërbime dhe produkte sipas standardeve duke krijuar të ardhura.

Duke qënë se Sh.a. ekzistuese projektohet të ketë shtim të fushës së veprimtarisë edhe në sektorin turistik apo kulturorë, u propozua në mbledhjen e fundit të këshillit Bashkiak, e cila nuk u realizua, që të kemi një emërtim të ri duke shtuar edhe objektet e veprimtarisë për Sh.a.

• **Në lidhje me pikën 5**, ku kërkoni; *Nëse kjo pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Këshillit Bashkiak do të miratohej, sa do të ishte sipërfaqja e plazheve publike, që do i merrte përsipër shoqëria aksionare “Bio Strajca”?*, ju informojme se;

VKM nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” Sh.a. ben nje ndryshim thelbesor të menaxhimit të plazheve në Shqipëri duke bërë që të vetmit subjekte që menaxhojnë hapsirat stacione plazhesh të jenë strukturat akomoduese apo të tjera subjekte sipas VKM dhe Bashkitë.

Sqarojmë që në zbatim të VKM nr.649/2024 dhe hartes së miratuar sipërfaqet renore ndahen cdo 1000 metra 700 metra sipërfaqe e menaxhueshme 300 metra siperfaqe publike.

- 300 metra siperfaqe publike do te mbese serisht publike pra pa pagese

- Po te miratohej kjo pike pjesa e mbetur nga sipërfaqet e menaxhueshme do te kalonte ne menaxhim për Sh.a.

• **Në lidhje me pikën 6**, ku kërkoni; *A ka ndonje subjekt privat, që do të merrte përsipër menaxhim kjo shoqëri?*, ju informojme se;

E drejta e menaxhimit të plazheve është vetëm për subjektet sipas VKM nr.649/2024 dhe Bashkisë e cila nuk ka të drejtën e nënkontraktimit të sipërfaqeve që do të kalonin në menaxhim për më tepër referojuni Projekt Vendimit nr. 6961/1 Prot datë 01/04/2025 ku pika 4 specifikonte që Sh.a. nuk ka të drejtë t’ja japë këtë hapësirë me qira apo ta shfrytëzojë me të tretë.

<https://bashkiashkoder.gov.al/projektvendime/projektvendimet-per-shqyrtim-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-bashkise-shkoder-date-8-prill-2025/>

• **Në lidhje me pikën 7,8**, ku kërkoni ;*Po fondi për menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e plazheve publike nga shoqëria aksionare “Bio Strajca”, sa do të ishte? Dhe Si mendoni ta zgjidhni këtë projektvendim që nuk u miratua nga anëtarët e tjerë të Këshillit Bashkiak? A keni ndonjë plan tjetër alternativ?*, ju informojme se;

Referojuni Projekt Vendimit nr. 6887/1 datë 28/03/2025
<https://bashkiashkoder.gov.al/projektvendime/projektvendimet-per-shqyrtim-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-bashkise-shkoder-date-8-prill-2025/>

KRYETAR

Benet BECI